



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:057939  
Datë: 22.04.2024  
Numri i dokumentit: 05601735

**C.nr.493/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit A.M. nga P., të cilin e përfaqëson Ardit Ibraj, avokat në Pejë, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania .. sh.p.k me seli në Vitomicë, Rajoni III, me bazë juridike mospagim i qirasë, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seance me datën 22.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET e tërhequr** padia e paditësit A.M. nga P., e parashtruar me datë 27.05.2020, kundër të paditurës Kompania ..... sh.p.k, me seli në Vitomicë, Rajoni III-të, Komuna Pejë, me bazë juridike mospagim i qirasë.

**II.** Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë, paditësi A.M. nga P., ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania.... sh.p.k me seli në Vitomicë, Rajoni III-të me bazë juridike mospagim i qirasë.

Gjykata, me datën 26.02.2024, ka pranuar parashtresën e paditësit, me anë të së cilës parashtresë, i njëjti ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës për shkaqe objektive dhe subjektive. Parashtresën në fjalë dhe njoftimin konform dispozitës ligjore përkatësisht nenit 261 par.1 dhe 2 të LPK-së, gjykata i ka dërguar të paditurës, të cilën e njëjta e ka pranuar 14.03.2024, por që nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e*

*padisë*”, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.493/20, me datë 22.04.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.